32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jene lëshuar, ose konsiderohet të jene lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

## **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

## **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

## **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimi;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 643-25-753-5-1-1/C552

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është:  <b>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës, në kohëzgjatje prej 37 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.</b>  Sigurimi i ekzekutimit duhet të dorëzohet në mënyrë fizike nga Operatori ekonomik fitues me rastin e nënshkrimit të Kontratës në Zyren e Prokurimit –Komuna Skenderaj.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës.  - Do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord mes paleve kontraktuese;  - Do të sigurojë për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara;  - Duhet të siguroj që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj;  -Do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim;  - Do të sigurojë sigurinë në Vend - punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit - do të mbajë një regjistër të punëve në rast të kontratave për punë.  <i>(iii)Përpos sigurisë në nenet e lartpërmendura të kësaj kontrate parashihet edhe mbrojtja e shëndetit të punëtorëve të kontraktuesit: ku do të zbatohen dispozitat pozitive të Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin e punëtorëve në punë, dhe nese vjen deri të ndonjë rast do të zbatohen dispozitat e këtij Ligji respektivisht Neni 8 par.4: dhe në rast se ndodh rasti përgjegjësinë e mban kontraktuesi dhe nënkontraktuesi</i>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	5.4	Menaxheri i kontratës duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë menaxheri i kontratës duhet do të përgatis dhe krijoj një plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi I prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlerë të

		<p>madhe, të mesme dhe të vogël.</p> <p>Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës.</p> <p>Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të Menaxherit të Kontratës nga ana e AK dhe menaxherit të kontratës nga ana e Operatorit Ekonomik.</p> <p>Pas aprovimit dhe nënshkrimit të Planit për menaxhim të kontratës, i njëjti plan do të jetë në dispozicion për shkarkim nga ana departamentit të prokurimit.</p> <p>Pasi Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit shkarkon dhe rishikon planin për menaxhimin e kontratës, Menaxheri i Kontratës do t'i lëshojë Operatorit Ekonomik:</p> <p>a. Letrën e fillimit të punëve, në rastin e kontratës për punë;</p> <p>- Menaxheri i Projektit do të:</p> <p>(a) Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;</p> <p>(b) sigurojë se o përdori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë dhe</p> <p>(c) Bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.</p> <p>- Funksionet e Menaxherit të Projektit janë:</p> <p>a) Të sigurojë që operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo, dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;</p> <p>b) Të sigurojë që operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;</p> <p>c) të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;</p> <p>d) Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;</p> <p>e) Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;</p> <p>f) Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgaditen, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;</p> <p>g) Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;</p> <p>h) T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;</p> <p>i) Të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimit;</p> <p>j) Te jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimi; dhe</p> <p>k) T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.</p> <p>Përgjegjësitë e Mbikqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës Mbikqyrësit i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për:</p> <p>a) mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të implementimit të kontratës;</p> <p>b) administrimin e plotë të kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual në kontratë; dhe</p> <p>c) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij.</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.

	12.2	
Fillimi i punëve	17.1	<p>Punimet fillojnë me datën e urdhëresës së Letres për fillimin e punimeve në formë elektronike, me e-mail zyrtar apo në formë fizike nga Menaxheri i Kontratës, i emëruar me vendim të ZKA-se;</p> <p>Data e fillimit do të jetë sipas Planit të Menaxhimit të Kontrates, pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.</p>
Perfundimi i punimeve	17.2	<p>Data e përfundimit të gjitha Punëve do të jetë për:  <b>745 ditë</b> pune jo kalendrike me ditat e punës, të nxjerr nga menaxheri i kontratës/organi mbikëqyrës brenda viteve 2025-2026-2027.</p> <p>-Pranimin e punëve, bëhet nga komisioni në përbërje të plotë prej tre (3) apo (5) anëtarësh të emëruar me vendim të caktuar, me Ligjin - Rregulloret në fuqi.</p>
Dëmet e likuiduara	19.1	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës</p>
Inspektimi dhe testimi	22.1	<p>Menaxheri i Kontrates/projektit nga AK-Skenderaj, rezervon të drejtën ligjore që në çdo kohë të bëjë verifikimin e cilësisë së materialit/punëve në vend punishte drejtpërdrejtë.</p> <p>Menaxheri i Kontrates/ Projektit, gjatë pranimit të përkohshëm nëse konstatojnë se ka defekte do të lajmërohet menjëherë Kontraktuesin, që të bëjë korrigjimin e defekteve të tilla, deri të pranimit të përgjithshëm – pranim dorëzimit të objektit. Kontraktuesi përmiresimin dhe riparimin e defekteve e bënë në kuadër të shpenzimeve të tij.</p>
Pagesat	24.1	Pagesat do të bëhen në Euro. Konform Ligjit për menaxhimin e Financave Publike në Republikën e Kosovës.
Parapagimi	26.1	N/A
Mbajtja e Parasë	27.1	<p>Ndërsa Pagesa për situacionin e fundit të certifikuar nga menaxheri i kontratës / organi mbikëqyrës i punëve do të bëhet me dorëzimin e garancionet nga OE. Punë kryesi, në vlerë 10%, të kontratës së përgjithshme, sjell garancionin i cili do të jetë pjesë përbërëse e kësaj kontrate, në kohëzgjatje prej 24 muaj, pas pranimit-dorëzimit të punimeve;</p> <p>Pagesat do të bëhen nga Autoriteti Kontraktues, me plotësim të dokumentacionit të lart cekur dhe faturën origjinale të Kontraktuesit me numrin e xhironlogarisë bankare.</p>
Shkaqet për kompensim	30.1	

Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	<p>Periudha garantuese e defekteve do të jetë 24 muaj pas përfundimit të kontratës</p> <p>Kontraktuesi është i obliguar që sipas kërkeses së Autoritetit Kontraktues, të bëjnë permisimin – intervenimin për gjatë kohës së periudhës së garantimit.</p> <p>Operatori Ekonomik, Kontraktuesi i Punimeve duhet ta dorëzojë sigurimin e ekzekutimit në vlerë 10% të kontratës së përgjithshme, ku ky garancion do të jetë pjesë përbërëse e kësaj kontratës, në kohëzgjatje prej 24 muajve, pas pranimit dorëzimit përfundimtar të punëve.</p> <p>Ky garancion i ekzekutimit duhet të jetë nga një Kompani Sigurimesh të licensuar në Republikën e Kosovës.</p> <p>Sigurimi i ekzekutimit për garantimin e punëve – objektit të përfunduara duhet të silllet në Autoritetin Kontraktues me pagesën e fundit.</p>
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	<p>Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e punëve, është vlera e punëve të kryera të pranueshme.</p> <p>Nëse me fajin e OE vjen deri të shkëputja e kontratës atëherë me marrëveshje të palëve automatikisht shkëputet kontrata dhe pasojnë dënimet për OE si: nuk paguhet mjete nga ana e Autoritetit Kontraktues për punët e pakryera dhe llogariten demot e shkaktuara për moskryerjen dhe zhagjitjen e punimeve që i paguan punë kryesi dhe automatikisht i konfiskohet sigurimi i ekzekutimit shuma 10% e vlerës totale të kontratës nga ana e Komunitetit të Skenderajt.</p>
		<p>Palët do të provojnë në mënyrë miqësore të zgjidhin marrëveshjet ku do të organizojnë së paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kanë efekt atëherë kompetente do të jetë gjykata.</p> <p>Ne pajtim me kushtet e përgjithshme të kontratës- nënshkruesit e kontratës brenda periudhës një ( 1 ) javore, do të fillojnë negociatat dhe bisedat për zgjidhjen e mos marrëveshjeve të lindura gjatë implementimit të kontratës.</p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve në mes të dy palëve
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedurë gjyqësore	32.1	<p>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet tek <b>[Gjykata Themelore Prishtinë-Departamenti Ekonomik]</b>.</p> <p>Ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

# PARAMASA DHE PARALLOGARIA

PROJEKTI: Projektimi i Objektivit të Muzeut dhe Bibliotekës në Skenderaj

LOKACIONI: SKENDERAJ

INVESTITORI: KOMUNA SKENDERAJ

VËREJTJE:

Materialet e propozuara në paramasë janë pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me certifikatat apo testet e ofruara nga prodhuesit respektiv por çdoher të aprovuara nga Organi Mbikqyres respektivisht Drejtoria përkatëse. Në të gjitha pozicionet përfshihet FURNIZIMI DHE MONTIMI/PUNIMI I ATIJ POZICIONI. TEK PASTRIMET, DEMOLIMET E ÇERMIMET TË PËRFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NË DEPONË

## ARKITEKTURA DHE PARTERI

### ARKITEKTURA

1.00 PUNET PARAPREGADITORE

POS PËRSHKRIMI I PUNËVE

		NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.10	Pozicionimi gjeodezik dhe shënjestrimi i objektit dhe gjithë parterit, si dhe percjellja gjeodezike e të gjitha fazave të specifikuar në projekt. Hartimi i projektit të ekzekutuar me të gjitha fazat e kryera të punimeve brenda dhe jashtë objektit. Projekti të dorëzohet në drejtorinë përkatëse në 3 kopje dhe CD	copë	1.00	30,000.00 €	30,000.00 €
1.20	Rrethimi dhe sigurimi i punishtës me konstrukcion metalik. Organizimi i punishtës dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit; kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndërtimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyrën e menaxhimit të projektit dhe vendosja e WC kabinave për nevojat e punëtorëve.	copë	1.00	30,000.00 €	30,000.00 €
1.30	Pastrimi i tërësishëm i terrenit rreth objektit pas përfundimit të punimeve nga të gjitha objektet apo strukturat e përkohshme, rrethojat, mbeturinat inerte dhe ambalazhet e paketimet e materialeve, si dhe demolimi i gjithë hapsirës të planifikuar për ri-ndërtim, objekteve deri në kuotat e planifikuara me specifika sipas projektit, demolimi dhe largimi i gjithë materialeve ekzistuese në objekt si dhe dërgimi i materialit në depo deri 15km nga vendpunishja. Si dhe çdo material tjetër që cakton organi mbikqyres	copë	1.00	30,000.00 €	30,000.00 €
<b>TOTAL POZICIONI</b>					<b>90,000.00 €</b>

2 PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT

POS PËRSHKRIMI I PUNËVE

		NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
2.10	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi t=25 cm me fraksion 0-63mm dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë Ms=70 MPa per aneksin e hyrjes në objekt.	m <sup>3</sup>	2,037.60	35.00 €	71,316.00 €
2.20	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi t=15cm me fraksion 0-31.5mm dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë Ms=80 Mpa per aneksin e hyrjes në objekt.	m <sup>3</sup>	1,018.80	34.00 €	34,639.20 €
<b>TOTAL POZICIONI</b>					<b>105,955.20 €</b>

3 PUNËT E BETONIT

POS PËRSHKRIMI I PUNËVE

		NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
<p><b>VËREJTJE 1:</b> Punëkryesi është i obliguar që të merr mostrat e betonit për çdo parti betoni, të kujdeset për mirëmbajtjen e tyre, dërgimin në laboratore të specializuara shqyrtimet e nevojshme dhe sigurimin e raporteve përkatëse për të gjitha mostrat.</p> <p><b>VËREJTJE 2:</b> Për pozicionet e parapara të betonohen me shtesa të specifikuar si më poshtë punëkryesi obligohet që të veprojë sipas udhëzimeve të prodhuesit du përmbajtur reçetës së përzjerjes, duke respektuar raportet e përzjerjes ujë-çimento-agregat ndërsa aditivet e kërkuara duhet të shtohen në mikser pas ardhjes punishtë në praninë e organit mbikqyres.</p>					
3.10	Furnizimi me material dhe betonimi me beton të varfër sipas projektit dhe specifikave në projekt. Betonimi të bëhet me beton të markës C-16/20MPa t=10cm. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	250.00	100.00 €	25,000.00 €
3.20	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i themeleve shiritore dhe kontraplakave, shkalleve të parapara dhe rampave si dhe çdo disnivel tjetër të paraqitur në projekt sipas projektit dhe specifikave në projekt. Betonimi të bëhet me beton të markës C-25/30MPa. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	1,120.00	120.00 €	134,400.00 €
3.30	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i Mureve. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37MPa. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	420.00	130.00 €	54,600.00 €
3.40	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i shtyllave, trajeve. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37MPa. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	120.00	130.00 €	15,600.00 €
3.50	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i pllakes së katit. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37MPa. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	465.00	130.00 €	60,450.00 €
3.60	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i Murit perimetrik mbrpjetes perreth parcelles dhe parterit të objektit sipas situacionit. Në pozicion përfshihet betonimi i themelit dhe murit. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37MPa. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	533.82	130.00 €	69,396.60 €
<b>TOTAL POZICIONI</b>					<b>359,446.60 €</b>

4 PUNËT E ARMIMIT DHE PROFILEVE NGA HEKURI SIPAS SPECIFIKIMEVE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
4.10	Furnizimi me material, prerja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve të armaturës së brinjëzuar sipas planeve dhe specifikeve të armaturës. Nga Ø8 deri në Ø 20	kg	230,984.07	1.20 €	277,180.88 €
4.20	Furnizimi me material, prerja dhe vendosja e profileve nga hekuri për mbulesën e objektit si dhe kapriates së objektit duke u bazuar në dizajnin e arkitektures dhe	kg	118,418.32	1.20 €	142,101.98 €
TOTAL POZICIONI					419,282.87 €
5.00 PUNËT E MURATIMIT					
PËRSHKRIMI I PUNËVE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	TOTAL
5.10	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 25cm dhe 12cm me blloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaq të fituar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtangim.	m <sup>2</sup>	355.00	70.00 €	24,850.00 €
TOTAL POZICIONI					24,850.00 €
6.00 PUNËT E SUVATIMIT ESTRIHUT EPOKSIT DHE PATENIMIT					
PËRSHKRIMI I PUNËVE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
6.10	Suvatimi i murit tek monamenti i Okarines ku në pozicion përshihen të gjitha shtresat paraprahe që nga kontakt betoni e deri në finalizimin me fasade ku trashësinë dhe dendësinë e percakton autoriteti kontraktues. Suvatimi të jete rezistent ndaj çdo temperature dhe ambientit të jashtëm.	m <sup>2</sup>	308.00	18.00 €	5,544.00 €
6.20	Furnizimi me material dhe Suvatimi e Patinimi i tavanëve mureve, shtyllave dhe çdo pozicioni tjetër dhe të gjitha elementeve tjera horizontale të nevojshme për, suva të specifikuar edhe me projekt që nga lyerja me beton kontakt deri në masën finalizuese Glet. Trashësia e suvatimit 0,8mm-1,5cm. Në tërë sipërfaqen ku punohet suvaja patjetër të punohet me rrejtje prej fibrave të xhami me hapje 5mm. Te gjitha sipërfaqet paraprakisht të trajtohen me paralyerje në sipërfaqet me beton: Betokontakt; në sipërfaqet me blloqe silikate: K. Aufbrennsperre. Trajtimi final i sipërfaqeve në kualitetin K3, me prajmer SpezialGrund; si dhe me masë patinuese K. Top Finish. Te gjitha suvatimet duhet të punohen sipas normave DIN 18202. Llogaritë në metër katror.	m <sup>2</sup>	5,250.00	6.00 €	31,500.00 €
6.30	Furnizimi material dhe punimi i Estrihut me trashësi min. 5cm - 10cm me përforcim të fibrave/fije nga qelqi. Shtresa e estrihut punohet me masë nga betoni i tharë në raport (rërë: çimento= 2:1) përfshirë fugmasen në takim me muret perimetrike me Poliester t=2cm, të gjitha fugat (me prerje me tëh të holla) e nevojshme dhe patinimi standard me makineri adekuate patinuese në sipërfaqe. Në sanitare duhet të punohet me rënje 0,5+1% në drejtim të ujëmbledhësve. Estrihu duhet të kontrollohet me nivelet "laser" dhe nuk duhet të ketë deformim më të madh se 4mm. Para dhe gjatë nivelimit të konsultohet projekti dhe koordinohen kuadrat e dyshemeve finale që nivelimi të punohet saktë. Llogaritë në metër katror.	m <sup>2</sup>	1,860.00	15.00 €	27,900.00 €
6.40	Furnizimi dhe punimi i dyshemeve nga Epoksid-Poliuretani për sipërfaqen totale të objektit. Karakteristikat e sistemit duhet të jenë me emitim të VOC, pa-tretës, elastik (jo plasaritese) me forcë të mirë mekanike, rezistencë shumë të lartë ndaj zbardhjes (ndërrimit të ngjyrës), të jete komode për ambient dhe absorbuës i zërit, anti-rreshqitës, e lehtë për tu aplikuar dhe për tu mirëmbajtur. Ngjyra RAL 7035. Në çmimi të parashihen dhe punohen këndoret perimetrike dhe të gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Kjo dysheme duhet të jetë me trashësi dhe materiale në përputhje me fletën e të dhënave teknike të dhe më kualitet nga prodhues të certifikuar me ISO9001/ EN 29001. Llogaritë në metër katror.	m <sup>2</sup>	1,860.00	35.00 €	65,100.00 €
TOTAL POZICIONI					130,044.00 €

7.00 FASADA STRUKTURALE DHE ALECBONDI					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
7.10	<p>Fasada gjysmë-strukturale nga aluminit termik sistemi me kapak, profile me ngjyre te zezë mat, profilet vertikal: thellësia e profilit te shinave min. 120mm; gjerësia min. 50mm, profilet horizontal: thellësia e profilit te shinave min. 60mm, gjerësia min. 50mm me izolim termik sipas standardeve BS EN ISO 140-3:1995 dhe BS5821. Te llogariten dyert me hapje, krahët qe hapen te pajisen me bagllame me tri pjese dhe tri goma perimetrike, dorezat krome. Dyert te jene me brava me cilindër për qelës dhe mekanizmin vetëmbyllej. Dyert duhet te punohen me profile nga alumini termik me gjerësi 85mm. Profilet termike, termo ndërprerje, minimumi i trashësisë se profilit 1.5mm, me peshe specifike 1.8Kg/m' te ngjyrosur fabrikisht me ngjyre te zezë mat deri 60 mikron.</p> <p>Xhama te dyfishtë (termopan) float 6+16+4mm, (xhami i jashtëm: 6mm, xhami i brendshëm 4mm Low-E), hapësira e vakuimit e mbushur me gaz argon. Xhamat transparent, i laminuar nga brenda dhe temperuar nga jashtë.</p> <p>Vlera e përgjithshme e kalimit te temperaturës ne dritare/dyer (xhama dhe profile) nuk duhet te jete me e madhe se <math>U=1.1 \text{ W/m}^2\text{K}</math>. I ter pozicioni te punohet dhe montohet sipas projektit kryesor/skemës se hapjeve dhe udhëzimeve te prodhuese te certifikuar.</p> <p>I ter pozicioni te punohet dhe montohet sipas projektit kryesor/skemës se hapjeve dhe udhëzimeve te prodhuese te certifikua. Ne pozicion perfshihet cdo hapje (derë) e planifikuar</p>	m <sup>2</sup>	340.00	120.00 €	40,800.00 €
